



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 42
Prishtinë, më 05 mars 2010
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10
Mbledhja filloi në orën 11:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Morën pjesë anëtarët e Komisionit: Rustem Mustafa, Shkumbin Demaliaj, Zylfi Merxha, Suzana Novoberdaliu, Radmila Vujoviq, Lulzim Zeneli dhe Melihate Termkolli.

Munguan: Zafir Berisha dhe Eqrem Kryeziu.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Antigona Ibraj, Nuredin Ibishi, Blerina Pula, Afrim Hoti dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetari i Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të **04. 02. 2010** dhe **09. 02. 2010**,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë,
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

Kryetari i Komisionit – Unë desha t’i njoftoj anëtarët e Komisionit për anëtarin e re të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe njëkohësisht t’i dëshiroj mirëseardhje në mbledhje Radmila Vujoviqit. A pajtoheni me këtë rend dite?

Melihate Termkoll – Unë pajtohem, mirëpo në mbledhjen e kaluar e kemi lënë një çështje të hapur. Në pyetje është përgjegjësia e MPB - së për ngjarjet që kanë ndodhur me protestat e Njësisë së Specializuar të Policisë dhe përgjegjësinë e ministrit. Mendoj që kjo çështje duhet të jetë si pikë e veçantë e rendit ditës.

Kryetari i Komisionit – Kjo çështje duhet të diskutohet, sepse informata nga MPB - ja, është shumë e mangët.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të 04. 02. 2010 dhe 09. 02. 2010

Procesverbalet e 04. 02. 2010 dhe 09. 02. 2010 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë

Kryetari i Komisionit – Ju e dini se në mbledhjen e kaluar janë miratuar amendamentet për këtë projektligj. Mirëpo kemi lënë mundësinë për inkorporim të ndryshimeve të tjera. Disa ndryshime janë bërë nga AKI - ja dhe ICO - ja. Komentet e dhëna janë shqyrtuar prej grupit të punës dhe janë vlerësuar si të rëndësishme. Disa nga ato ndryshime janë inkorporuar në raportin me rekomandime. Ju ftoj që t’i shikoni dhe mbase keni ndonjë vërejtje.

Melihate Termkoll - Te amendamenti 9 është një gabim teknik, duhet të shkruhet: “*sa*” në vend të “*sa*”.

Suzana Novoberdaliu – Neni 5, te titulli: “*Klasifikimi i ndaluar*”, pse është ndryshuar në “*Ndalimi i klasifikimit*”?

Kryetari i Komisionit – Ky nen ka të bëjë me informatat që janë të ndaluara të klasifikohen, për këtë arsye është ndryshuar titulli.

Lulzim Zeneli – Tek amendamenti i 13, duhet të bëhet një përmirësim te kompetenca origjinale. Fjala “*origjinale*” zëvendësohet me “*origjinere*”.

Radmila Vujoviq – Tek amendamenti 17, fjala “përcaktuar” zëvendësohet me “caktuar” dhe e kam të paqartë se si është rregulluar.

Kryetari i Komisionit – Ky amendament është miratuar në mbledhjen e kaluar.

Anëtarët e Komisionit miratuan raportin me amendamente për Projektligjin.

5. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit – Jam i pakënaqur me informatën nga MPB - ja, për protestën e Policisë së Kosovës. Në mbledhjen e ardhshme do të kemi një pikë të veçantë të rendit të ditës, ku do të diskutohet se çka do të ndërmerret për përmirësimin e komunikimit ndërmjet institucioneve.

Në seancën e 25 shkurtit në Kuvend e kanë miratuar Planin e Veprimit nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian. Ne, si Komision, i kemi obligimet tona dhe Shkumbin Demaliaj ka qenë i caktuar për këtë çështje.

Shkumbin Demaliaj – Linjat buxhetore i kanë sjellë këto probleme që janë sot, për shkak të pamundësisë së implementimit të ligjit për Policinë.

Melihate Termkoll – Unë edhe më herët kërkoja që kjo çështje të jetë pikë e rendit të ditës. Ky material që ka ardhur nga MPB - ja, as nuk mund të quhet informatë. Është një e vërtetë e madhe se kjo Ministri nuk i përgjigjet këtij Kuvendi, së paku jo këtij komisioni. Kjo ministri nuk i përmbush kërkesat elementare, qoftë edhe për sjelljen e një informate. Ne asnjëherë nuk kemi pasur një informatë të mirëfilltë për një çështje që e kemi kërkuar. Unë mendoj se kjo çështje duhet të jetë pikë e vetme e rendit të ditës në mbledhjen e ardhshme dhe duhet të merren vendime për aq sa janë kompetencat tona.

Lulzim Zeneli – Lidhur me çështjen e informatës unë mendoj se informata është e mangët. Ekzekutivi i vendit ose resorët e caktuar nuk i përfillin kërkesat, ose natyrën e punës së Komisionit, në mënyrë që të informojnë dhe raportojnë në momente të caktuara. Përveç asaj që kjo informatë duhet të jetë më e detajuar, unë mendoj se do të duhej të jetë i pranishëm ministri dhe ta mbrojë këtë informatë. Ne mund të kemi pyetje për këtë çështje e që nuk janë pjesë e kësaj informate. Unë pajtohem që të kërkohet një informatë më e detajuar. Përpos kësaj kemi rastin që pat ndodhur kohë më parë për vjedhjen e dhomës së dëshmimeve dhe ne asnjëherë nuk kemi marrë ndonjë informatë, se deri ku kanë shkuar hetimet. Është esenciale që të krijohet një raport i rregullt i informimit në Kuvendin e Kosovës, të kemi një informatë të rregullt. Duhet të kërkohet informata, po edhe prezenca e ministrit në Komision.

Pasi që nuk kishte pika të tjera për diskutim, kryetari i Komisionit e mbylli takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40

E hartoi:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Rrustem Mustafa